



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 20/05/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18/05/2020, të parashtruar nga grupi i Operatorëve Ekonomik GASHI EG& EKO DRINA SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit verorë në qytetin e Lipjanit", me Nr. të Prok: 613-20-1512-2-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e grupit të Operatorëve Ekonomik GASHI EG & EKO-DRINA SH.P.K e datës 18/05/2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit verorë në qytetin e Lipjanit", me nr. të Prok: 613-20-1512-2-2-1 nr.brendshëm 613 020 001 221 kundër *Vendimit të AK-së*, të datës 13/05/2020 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.
2. **Anulohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë**, për grupin e operatorve ekonomik GOE N.SH,CLEAN&KRONI GROP SH.P.K të publikuar me datë: 13/05/2020 dhe lënda kthehet në Rivlersim;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në Rivlersim për aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grupit i Operatorëve Ekonomik GASHI E G& EKO DRINA SH.P.K më datë 18/05/2020 ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit verorë në qytetin e Lipjanit”, me Nr. të Prok: **613-20-1512-2-2-1** Nr. brendshëm 613 20 001 221 **për shpërblim me kontratë**, për grupin e operatorve ekonomik N.SH,CLEAN&KRONI GROP SH.P.K, të datës 13/05/2020 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 19/05/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim ne si autoritet kontraktues kemi konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të arsyeshme sepse grupi i operatorve ekonomik N.SH,CLEAN&KRONI GROP SH.P.K. referencat e ofruara nga ky grup janë kryesisht për mirëmbajtje të ndërtesave gjë që komisioni i vlersimit gabimisht i ka marrë shërbime te ngjashme dhe pas konsultimeve me ekspertë kësaj lanie konsiderohet se këto dy fusha nuk mundemi t’i konsiderojmë të ngjashme.

Gjithashtu qëndron edhe pretendimi i dytë sepse grupi i i operatorve ekonomik i rekomanduar për kontratë tek pajisjet ka prezentuar dokumentacionin për autocisternë, kamion për pastrimin e rrugëve dhe makinë speciale për pastrimin e rrugëve por i mungon kamioni për bartjen e mbeturinave.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Adem Durigj

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

